



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 526 Prot.

Tiranë, më datë 18.02.2020

**VENDIM**

**Nr. 47, datë 19.02.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134 dhe V.K.M Nr.208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit të Bashkisë Durrës “Rehabilitim i rrugës “Egnatia”, Loti II”, Durrës, zona arkeologjike “B”, në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Rehabilitim i rrugës “Egnatia”, Loti II”, Durrës, zona arkeologjike “B”, kërkesë e Bashkisë Durrës;
2. Të kryhet ndjekja e punimeve të zbatimit nga specialistët e DRTK Tiranë, e cila duhet të raportojë pranë IKTK;
3. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**

**Arta DOLLANI**

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**

